



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:248187

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05634190

CAP.nr.1638/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, me gjyqtaren individuale Hidajete Gashi Alaj në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh. A., me seli në Prishtinë, Rr. “Nëna Terezë” nr. 36, kundër debitorit S.A, nga fshati ..., komuna Skenderaj, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 1,860.94 euro duke vendosur në lidhje me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë –Dega në Skenderaj, PPP.nr.1/2022, i datës 27.04.2023, me datë 26.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e kreditorit KEK SH.A, rr. “Nëna Terezë”, nr.36, Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, PPP.nr.1/2022, i datës 27.04.2023, ANULOHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të serishëm.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin PPP.nr.1/2022, i datës 27.04.2023 ka vendosur si në vijim:

*“I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit S.A, nga fshati ..., komuna Skenderaj.  
II. SHFUQIZOHET Pjesërisht Urdhri për lejimin e Përmbarimit P.nr.1442/18 i datës 19.12.2018, për periudhën kohore prej datës 10.12.2006 deri me datën 31.12.2008 në shumë prej 1,408.67 euro si borxh i parashkuar dhe OBLIGOHET debitori S.A, që kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) Sh.A. me seli në Prishtinë, në emër të borxhit për konsumin e energjisë elektrike t’ia paguajë shumën prej 452.27 euro (katërqind e pesëdhjetë e dy euro e njëzet e shtatë cent), për periudhën kohore 01.01.2009 deri me datën 20.03.2013, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke filluar nga pranimi i këtij vendimi e deri në pagesën definitive.”*

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e kreditorit dhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së shkallës së parë të ndryshohet dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim apo që aktvendimi i atakuar të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë të rigjykim dhe rivendosje.

Gjyqtarja individuale e Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbarim me datë 19.12.2018, ndaj debitorit në bazë të dokumentit autentik- ekstraktit nga librat e kontabilitetit për periudhën kohore 10.12.2006 deri me 20.03.2013, në vlerë prej 1,860.94 euro.

Përmbaruesi Privat, me urdhrin P.nr.1442/18, i datës 19.12.2018, ka lejuar përmbarimin.

Debitori pas pranimit të aktvendimit për përmbarim ka paraqitur prapësim me propozim që të anulohet urdhri i përmbaruesit privat dhe të përfundohet procedura për këtë çështje.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, pas pranimit të prapësimi ka nxjerrë aktvendimin, PPP.nr.1/2022, i datës 27.04.2023 duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se pas shqyrtimit të kundërshtimit të debitorit, ka gjetur se prapësimi i tij është pjesërisht i bazuar, për shkak se kemi parashkrim të borxhit për periudhën kohore prej 2006-2008 ashtu që kërkesa duke iu referuar propozimit për përmbarim është parashkruar në tërësi, ndërsa sipas Gjykatës me rastin e nënshkrimit të kontratës me datë 28.08.2017 është ndërprerë parashkrimi, dhe për këtë arsye kjo Gjykatë ka vendosur sikurse në pikën II të dispozitivit të aktvendimit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit nuk e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n), e po ashtu gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë e si rezultat i kësaj ka ardhur edhe deri te zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Gjykata e Apelit vlerëson se dispozitivi i aktvendimit të atakuar është në kundërshtim me arsyetimin, ndërsa në arsyetim nuk janë dhënë arsye për faktet vendimtare, madje nuk janë dhënë arsye për pretendimet sipas prapësimi, arsyetimi është i mangët ashtu që edhe ato arsye që janë dhënë janë të paqarta dhe kontradiktore.

Kjo Gjykatë nuk e mbështet si të drejtë dhe të ligjshëm vendimin e gjykatës së shkallës së parë për faktin se nga shkresat e lëndës vërehet se kreditori dhe debitori kanë lidhur një kontratë për pagesën e borxhit dhe atë në shumë prej 1,950.94 euro. Në shkresat e lëndës po ashtu gjendet

edhe deklarata mbi dakordimin e borxhit, ku kreditori dhe debitori janë pajtuar që borxhi të paguhet në 18 këste në shumë prej 30.00 euro kësti. Debitori ka bërë pagesë të 3 kësteve, dhe më pas nuk i ka paguar këstet e tjera të cilat ka qenë i obliguar që ti paguajë me kontratë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, duke pasur parasysh nenin 3 të Kontratës për pagesën e borxhit, debitori ka bërë 3 vonesa të njëpasnjëshme e që sipas këtij neni sipas programit atëherë marrëveshja shkëputet dhe pjesa e paguar e borxhit nëse k fshihet, dhe pjesa e mbetur e borxhit i rikthehet duke përfshirë këtu edhe të gjitha ndëshkimet, nëse debitori shkakton këto vonesa. Po ashtu, nga shkresat e lëndës vërehet se kreditori me rastin e paraqitjes së propozimit për përmbarrim nga shuma totale e borxhit prej 1,950.94 euro i ka zbritur shumat të cilat debitori i ka paguar. Propozimi për përmbarrim është paraqitur në vitin 2018, ndërsa borxhi është kërkuar për periudhën prej vitit 2006 e deri në vitin 2013.

Kjo Gjykatë vlerëson se gabimisht është vlerësuar parashkrimi sepse është dashur që të llogaritet shuma e cila ka qenë i detyruar debitori që ta paguajë pas faljes së borxhit dhe të vlerësohet parashkrimi i kësteve dhe periudha deri kur ka pasur të drejtë kreditori që të kërkojë borxhin nga ana e debitorit. Duke pasur parasysh se Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar drejt afatin e parashkrimit, kjo Gjykatë vlerëson se kemi zbatim të gabuar edhe të së drejtës materiale, andaj vendimin e Gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta pranoj si të drejtë dhe të ligjshëm.

Në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet ti eliminoj shkeljet e konstatuara nga ana e kësaj Gjykate, ashtu që fillimisht të eliminoj shkeljet procedurale duke iu përmbajtur në përpikëri dispozitave të procedurës kontestimore dhe asaj përmbarrimore, të konstatoj edhe njëherë shumën e borxhit të kërkuar nga ana e kreditorit në bazë të propozimit për përmbarrim, të vlerësojë kontratën e lidhur dhe deklaratën mbi dakordimin e borxhit dhe të konstatojë saktë shumën e paguar nga ana e debitorit, të vlerësojë edhe njëherë parashkrimin e borxhit në raport me cilësinë e debitorit si lloj i veçantë i konsumatorit e më pas të marrë vendim të drejtë dhe të ligjshëm duke iu përmbajtur edhe dispozitave ligjore në fuqi.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së., u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.1638/2023, të datës 26.04.2024

Gjyqtarja  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.